


KODI I ETIKËS PËR MËSUESIT E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR



Tiranë, 2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 5292/Prot.
11

Tiranë më 4.9.2025

URDHËR
Nr. 435, datë 4.9.2025

PËR
MIRATIMIN E KODIT TË ETIKËS PËR MËSUESIT E SISTEMIT ARSIMOR
PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 26 të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të pikës 2, të nenit 29 të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të ligjit nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, të urdhrit nr. 31, datë 28.01.2020 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe të urdhrit nr. 32, datë 21.01.2025, “Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për fuqizimin e mekanizmave të parandalimit të çdo forme dhune e bullizmi dhe rritjen e sigurisë në institucionet arsimore parauniversitare”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e “Kodit të etikës për mësuesit e sistemit arsimor parauniversitar”, sipas tekstit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij Urdhri.
2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Drejtorja e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI
OGERTA MANASTIRLIU



PËRMBAJTJA

Preambul.....	3
KREU I	
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	4
Neni 1 Qëllimi.....	4
Neni 2 Përkufizime	4
Neni 3 Fusha e zbatimit	5
KREU II	
PARIMET THEMELORE	5
Neni 4 Parimet etike dhe profesionale të mësuesit	5
KREU III	
STANDARDET E SJELLJES PROFESIONALE	6
Neni 5 Etika në komunikim e mësuesit.....	6
1. Marrëdhënia me nxënësit dhe përkushtimi	6
2. Marrëdhënia me prindërit/personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore	7
3. Marrëdhënia me institucionin arsimor parauniversitar	7
4. Marrëdhëniet me kolegët	8
Neni 6 Etika në sjellje dhe në mjedisin shkollor.....	8
Neni 7 Etika në mjedisin komunitar.....	8
Neni 8 Etika në veshje dhe në paraqitjen e jashtme.....	9
Neni 9 Etika në rrjetet sociale dhe platformat online.....	9
1. Etika në përdorimin e platformave dhe rrjeteve sociale.....	9
2. Roli publik i mësuesit	9
Neni 10 Koha e punës	9
KREU IV	
DISPOZITA KALIMTARE.....	10
Neni 11 Zbatimi i kodit dhe përgjegjësitë.....	10
KREU V	
DISPOZITA TË FUNDIT	10
Neni 12 Hyrja në fuqi dhe zbatueshmëria.....	10

Preambul

“Kodi i Etikës së Mësuesit” përcakton standardet e sjelljes që duhet të udhëheqin çdo mësues të sistemit arsimor në Shqipëri, në shërbim të zhvillimit të një arsimi cilësor dhe gjithëpërfshirës. Roli i mësuesit në formimin e brezave të rinj, kërkon integritet, maturi dhe përgjegjshmëri.

Ky Kod merr në konsideratë direktivat e Bashkimit Evropian për etikën në arsim, Kodin e Etikës për Mësuesit të Këshillit të Evropës, rekomandimet e UNESCO-s për etikën e mësuesit, kuadrin ligjor për sistemin arsimor në Shqipëri, si dhe traditën e respektit të thellë që shoqëria shqiptare ka për figurën e mësuesit. Ai synon të mbrojë dinjitetin e profesionit, rolin e mësuesit përcjellës i dijes dhe edukator, të forcojë besimin e komunitetit ndaj institucionit të shkollës dhe të krijojë një mjedis edukativ dhe përcues i vlerave të qytetarisë për të gjithë komunitetin brenda dhe jashtë shkolle.

Në këtë kuadër, miratimi dhe zbatimi i Kodit të Etikës për Mësuesit, është një domosdoshmëri për të siguruar integritetin profesional, për të ruajtur dinjitetin e figurës së mësuesit dhe për të ndërtuar besimin midis shkollës, nxënësve, prindërve dhe komunitetit.

Në përputhje me standardet dhe direktivat e Bashkimit Evropian për etikën në arsim, Kodi i Etikës për Mësuesin, bazohet në parime themelore si barazia, përfshirja, respekti për të drejtat e njeriut, profesionalizmi dhe transparenca. Praktikant më të mira evropiane theksojnë rëndësinë e një kornize të qartë etike, që ndihmon mësuesit të përballen me sfidat profesionale me integritet, sidomos në një realitet arsimor që transformohet me ritme të shpejta nga teknologjia dhe zhvillimet sociale dhe ekonomike.

Kodi i Etikës së Mësuesit përcjell vlerat tona të përbashkëta, respektin për mësuesin, si edukator i fëmijëve; ndershmërinë dhe përkushtimin ndaj detyrës; përgjegjësinë për të ndihmuar çdo fëmijë të arrijë potencialin e tij pavarësisht prejardhjes sociale apo ekonomike. Roli i mësuesit në kulturën shqiptare është e lidhur ngushtë me misionin shoqëror dhe kjo reflektohet qartë në çdo nen të kodit të ri.

Në këtë mënyrë, Kodi i Etikës për Mësuesit në Shqipëri është udhërrëfyes moral dhe profesional që bashkon vlerat evropiane me traditën kombëtare, duke vendosur bazat për një arsim që edukon dhe zhvillon dijet dhe karakterin.

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Kodi i etikës për mësuesit ka për qëllim të përcaktojë parimet dhe rregullat e sjelljes etike dhe profesionale të mësuesve në institucionet arsimore parauniversitare, me qëllim garantimin e integritetit, profesionalizmit, paanshmërisë dhe përgjegjshmërisë në ushtrimin e detyrës mësimore dhe edukative.

Neni 2

Përkufizime

Në kuptim të këtij Kodi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a. **“Institucion arsimor”** – çdo institucion arsimor parauniversitar që funksionon në përputhje me ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- b. **“Mësues”** – personi që ka fituar të drejtën për të ushtruar profesionin e mësuesisë në arsimin parauniversitar.
- c. **“Drejtnes”** – drejtori i institucionit arsimor ose nëndrejtori.
- d. **“Konflikt interesi”** – çdo situatë kur mësuesi ndodhet përballë një vendimmarrjeje apo veprimi, ku interesat e tij personale mund të ndikojnë, ose të perceptohet se ndikojnë, në ushtrimin e drejtë, të paanshëm dhe profesional të detyrës.
- e. **“Etikë profesionale”** – sjellja dhe qëndrimi në përputhje me parimet e ndershmërisë, respektit, integritetit, përkushtimit dhe përgjegjshmërisë në ushtrimin e profesionit mësimor.
- f. **“Standard profesional”** – normat e pranuar të sjelljes dhe performancës që priten nga mësuesit në procesin mësimor dhe në ndërveprim me nxënësit, kolegët, prindërit dhe komunitetin.
- g. **“Mjedis komunitar”** - vendi dhe kushtet ku jeton dhe bashkëpunon një grup njerëzish, duke përfshirë hapësirën fizike, marrëdhëniet mes tyre dhe rregullat që ndjekin.

Neni 3

Fusha e zbatimit

1. Kodi i Etikës së Mësuesit përcakton parimet themelore të sjelljes etike dhe profesionale, që rregullojnë marrëdhëniet e mësuesit me nxënësit, me prindërit/personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, kolegët, drejtuesit institucionalë dhe komunitetin, brenda dhe jashtë mjedisit shkollor, me qëllim promovimin e një klime edukative të sigurt dhe gjithëpërfshirëse.
2. Ky kod zbatohet edhe për praktikantët, që ushtrojnë praktikën profesionale në fushën e mësuesisë, sipas përcaktimeve të akteve nënligjore në fuqi, lidhur me organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit.

KREU II

PARIMET THEMELORE

Neni 4

Parimet etike dhe profesionale të mësuesit

Në një shoqëri që aspirojnë të ndërtojnë një sistem arsimor cilësor dhe të drejtë, roli i mësuesit mbetet themelor. Mësuesit janë jo vetëm bartës të dijes, por edhe model frymëzimi, drejtësie sociale dhe qytetarie për brezat e rinj.

1. **Integriteti personal:** Mësuesi vepron me ndershmëri, drejtësi dhe paanshmëri në çdo vendim dhe marrëdhënie të tij. Ai e ushtron detyrën e tij me përkushtim, kompetencë, dhe përgjegjësi, në përputhje me standardet më të mira në ushtrimin e profesionit, si dhe në interesin dhe zhvillimin e gjithanshëm të nxënësit. Mësuesi është profesionist që kërkon në mënyrë të vazhdueshme të përmirësojë kapacitetet e tij. Ai angazhohet të përfitojë njohuritë, të përqafojë risitë, të zhvillojë praktika bashkëkohore mësimdhënieje dhe të ndjekë zhvillimin profesional në çdo fazë të karrierës së tij në sistemin arsimor.
2. **Respekti për dinjitetin njerëzor:** Çdo individ trajtohet me dinjitet dhe pa paragjykim. Mësuesi është bartës i vlerave demokratike dhe qytetare. Ai inkurajon vlerat e tolerancës, solidaritetit, mendimit të lirë dhe respektit në jetën shkollare dhe shoqëri.
3. **Përgjegjësia ndaj nxënësit:** Mësuesi kujdeset për mirëqenien, zhvillimin dhe formimin e plotë të çdo nxënësi. Mësuesi sillet dhe vepron në mënyrë të paanshme, të drejtë dhe gjithëpërfshirëse, duke promovuar liritë e të drejtat themelore të njeriut.
4. **Barazia dhe përfshirja:** Mësuesi promovon një mjedis arsimor që përjashton çdo formë diskriminimi.
5. **Bashkëpunimi dhe profesionalizmi:** Mësuesi bashkëpunon me kolegët, prindërit, komunitetin dhe institucionet në frymë konstruktive në interesin më të lartë të nxënësit.

6. **Ruajtja e personalitetit të mësuesit:** Mësuesi është model në sjellje, komunikim dhe qëndrime, brenda dhe jashtë mjedisit shkollor. Mësuesi është model i fjalës së mirë, dialogut konstruktiv dhe ndërveprimit etik, brenda dhe jashtë mjediseve të shkollës.

KREU III

STANDARDET E SJELLJES PROFESIONALE

Neni 5

Etika në komunikim e mësuesit

1. Marrëdhënia dhe përkushtimi me nxënësit

- a. Mësuesi përdor me nxënësit gjuhë të qartë, edukative dhe motivuese.
- b. Mësuesi respekton privatësinë dhe dinjitetin e çdo nxënësi.
- c. Mësuesi luan rol proaktiv me nxënësit për të parandaluar fenomenet e dëmshme që ndikojnë negativisht në edukimin dhe mirëqenien e tyre. Ai vëzhgon, monitoron, parandalon dhe ndërhyr menjëherë në rastet e bullizmit apo çdo formë dhune apo përjashtimi social midis nxënësve brenda shkollës, sipas protokolleve përkatëse të shkollës.
- d. Mësuesi beson në suksesin e çdo nxënësi dhe siguron kushtet e të mësuarit për të gjithë.
- e. Mësuesi zhvillon dhe ruan marrëdhënie profesionale me nxënësit, bazuar në interesin më të lartë të tyre.
- f. Mësuesi kujdeset për mirëqenien fizike, emocionale, sociale dhe intelektuale të nxënësve për zhvillimin e plotë të potencialit të tyre.
- g. Mësuesi kujdeset për nevojat e ndryshme mësimore të secilit nxënësi.
- h. Mësuesi ofron më të mirën e mundshme profesionale për nxënësit dhe vlerëson arritjet dhe progresin e tyre në përputhje me parimet e vlerësimit.
- i. Mësuesi nxit nxënësit të mendojnë në mënyrë kritike dhe krijuese bazuar në programet mësimore dhe ato jashtëshkollore.
- j. Mësuesi i ndihmon nxënësit të vlerësojnë identitetin e tyre, të mësojnë më shumë rreth trashëgimisë kulturore dhe të ushtrojnë përgjegjësitë e tyre qytetare dhe shoqërore.
- k. Mësuesi, në punën e tij, është shembulli i integritetit, moralit të lartë dhe standardeve etike.
- l. Mësuesi është model i sjelljes dhe i zgjidhjeve paqësore në marrëdhëniet me nxënësit dhe të gjithë të tjerët.
- m. Mësuesi, përmes protokolleve standarde të punës gjatë procesit mësimor, është pjesë e mekanizmave të parandalimit dhe bashkëpunimit me të gjithë strukturat brenda dhe jashtë shkolle, kundër çdo lloj forme të mundshme të dhunës, diskriminimit, bullizmit për të garantuar sigurinë e nxënësve dhe mirërritjen e tyre.
- n. Mësuesi zbaton parimet e përgjithshme të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, në mënyrë të veçantë parimin e interesit më të lartë të fëmijës dhe atë të trajtimit të barabartë të tij.

- o. Mësuesi trajton me kujdes çdo informacion personal dhe të ndjeshëm për nxënësin duke respektuar privatësinë dhe duke ndjekur protokollet standarde të miratuara bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.
- p. Mësuesi ruan profesionalizmin në marrëdhëniet me nxënësit dhe i respekton ato brenda dhe jashtë mjedisit arsimor.

2. Marrëdhënia me prindërit/personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore

- a. Mësuesi komunikon në mënyrë të rregullt, të hapur dhe bashkëpunuese me prindërit/personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore.
- b. Mësuesi dëgjon shqetësimin e prindit/personit që ushtron përgjegjësinë prindërore me respekt dhe pa paragjykim.
- c. Mësuesi shmang çdo ndikim të padrejtë në vlerësimin apo trajtimin e nxënësit.
- d. Mësuesi krijon marrëdhënie të ndershme dhe të respektueshme me prindërit/ personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore.
- e. Mësuesi respekton të drejtat e prindërve/ personave që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore për t'u konsultuar për mirëqenien dhe përparimin e fëmijëve të tyre dhe respekton autoritetin e ligjshëm prindëror.
- f. Mësuesi bashkëpunon ngushtë me prindërit/ personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore për të krijuar një mjedis të sigurt dhe mbështetës për të gjithë nxënësit.
- g. Mësuesi bashkëpunon me prindërit/ personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore për të zgjeruar larminë e shërbimeve edukative që mund të ofrojë shkolla.
- h. Mësuesi informon rregullisht prindërit/ personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore për punën dhe arritjet e nxënësve, si dhe për nevojat apo çështjet me interes të përbashkët.
- i. Mësuesi bashkëpunon me prindërit/ personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore në vendimmarrjet për kujdesin dhe edukimin e fëmijëve të tyre.
- j. Mësuesi ruan privatësinë në komunikimin me prindërit/ personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore.
- k. Mësuesi, në punën e tij, është shembulli i integritetit, moralit të lartë dhe standardeve etike.

3. Marrëdhënia me institucionin arsimor parauniversitar

- a. Mësuesi zbaton detyrimet ligjore dhe administrative me integritet dhe profesionalizëm.
- b. Mësuesi respekton hierarkinë dhe komunikon në mënyrë etike dhe konstruktive me drejtuesit dhe kolegët.
- c. Mësuesi merr pjesë aktivisht në jetën shkollore, iniciativat zhvilluese me qëllim përmbushjen e misionit të tij si mësues.

4. Marrëdhëniet me kolegët

- a. Mësuesi respekton kolegët me fjalë dhe me veprime në zbatim të standardeve të etikës.
- b. Mësuesi bashkëpunon me kolegët për rritjen e cilësisë në mësimdhënie si dhe nxitjen e të nxënësve.
- c. Mësuesi bashkëpunon me të gjithë punonjësit arsimorë dhe joarsimorë, me qëllim garantimin e një mjedisi të sigurt dhe të shëndetshëm për nxënësit.
- d. Mësuesi nxit dhe mbështet kolegët e tij për arritjen, ruajtjen dhe zhvillimin e standardeve të larta në arsim.
- e. Mësuesi respekton informacionin konfidencial për kolegët, përveç rasteve kur kërkohet nga ligji.
- f. Mësuesi nuk ndikohet nga interesa personale në mënyrën se si trajton kolegët apo në kryerjen e detyrave profesionale.
- g. Mësuesi mbështet mësuesit e rinj dhe merr pjesë në përgatitjen dhe në trajnimin e tyre, si dhe në zhvillimin profesional të të gjithë stafit.
- h. Mësuesi, në punën e tij, është shembulli i integritetit, moralit të lartë dhe standardeve etike.

Neni 6

Etika në sjellje dhe në mjedisin shkollor

1. Mësuesi është shembull në sjellje dhe marrëdhënie me të gjithë stafin brenda dhe jashtë institucionit arsimor parauniversitar.
2. Mësuesi zbaton me përpikmëri rregulloren e brendshme të institucionit arsimor parauniversitar.
3. Mësuesi zgjidh konfliktet me qetësi, maturi dhe etikë.
4. Mësuesi kujdeset për një mjedis të sigurt, të pastër dhe gjithëpërfshirës për nxënësit.

Neni 7

Etika në mjedisin komunitar

1. Mësuesi bashkëpunon me pjesëtarë të tjerë të komunitetit jo vetëm për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies e të nxënësve, por dhe për të zgjeruar larminë e shërbimeve edukative që mund të ofrojë shkolla në komunitet.
2. Mësuesi angazhohet në aktivitete që forcojnë bashkëpunimin shkollë-komunitet dhe promovojnë vullnetarizmin si vlerë edukative për nxënësit.
3. Mësuesi, mbështet programet e shkollës si qendër komunitare.
4. Mësuesi bashkëpunon me komunitetin për çështjet me interes të përbashkët.
5. Mësuesi mbështet në mënyrë aktive programet që promovojnë mundësi të barabarta për të gjithë në komunitet e më gjerë.
6. Mësuesi përcjell vlera pozitive që pranohen gjerësisht në shoqëri.

Neni 8

Etika në veshje dhe paraqitjen e jashtme

- a. Veshja duhet të jetë e rregullt, profesionale, e pastër dhe e përshtatshme për mjedisin shkollor.
- b. Përdorimi i stolive (bizhuteri) dhe elementeve shtesë në veshje duhet të jetë i kujdesshëm dhe i përshtatshëm për mjedisin shkollor, duke shmangur stilitë (bizhuteritë) e mëdha, me ngjyra të forta ose që shkaktojnë tinguj, të cilat mund të tërheqin vëmendjen apo shpërqendrojnë nxënësit gjatë procesit mësimor.
- c. Kujdesi personal duhet të jetë në përputhje me normat për mjedisin arsimor dhe edukativ.

Neni 9

Etika në rrjetet sociale dhe platformat online

1. Etika në përdorimin e platformave dhe rrjeteve sociale

- a. Mësuesi ruan një sjellje të matur në paraqitjen publike të jetës personale, në mënyrë që të mos cenohet integriteti dhe imazhi i tij profesional.
- b. Mësuesi kujdeset që postimet në rrjetet sociale/foto/video të jenë në përputhje me etikën profesionale dhe rolin edukativ.
- c. Mësuesi kujdeset që ndërveprimi në rrjete apo platforma sociale të mbështetet gjithmonë në standardet etike të komunikimit në publik.

2. Roli publik i mësuesit

- a. Mësuesi ruan figurën e tij si model edukues, edhe jashtë mjedisit të punës.
- b. Mësuesi nxit etikën dhe sjellje të përgjegjshme në mjediset e institucionit arsimor parauniversitar, jashtë tij si edhe në internet, duke i mësuar dhe edukuar nxënësit rreth përdorimit të sigurt të platformave dhe rritjes së ndërgjegjësimit për rreziqet që sjell përdorimi i platformave jo të sigurta.
- c. Mësuesi edukon nxënësit për të dalluar informacionin e rremë dhe nxit të menduarin kritik, përfshirë rastet e informacioneve nga burimet digjitale.

Neni 10

Koha e punës

Mësuesi duhet të përdorë kohën e punës në mënyrë efektive dhe të përkushtuar për realizimin e detyrave mësimore, edukative dhe administrative që i janë ngarkuar.

KREU IV

DISPOZITA KALIMTARE

Neni 11

Zbatimi i kodit dhe përgjegjësitë

1. Çdo mësues ka për detyrë të lexojë, kuptojë dhe të angazhohet për zbatimin e këtij Kodi në praktikën e përditshme.
2. Drejtuesit e shkollës monitorojnë zbatimin e Kodit dhe adreson shkeljet në përputhje me rregullat e miratuara në fuqi.
3. Drejtuesit e shkollës dhe strukturat përkatëse të arsimit parauniversitar angazhohen për zbatimin me efikasitet të këtij Kodi.
4. Kodi rishikohet periodikisht për t'iu përgjigjur nevojave të reja të sistemit arsimor.

KREU V

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 12

Hyrja në fuqi dhe zbatueshmëria

1. Kodi i Etikës së Mësuesit hyn në fuqi pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe publikohet në faqen zyrtare të saj.
2. Dispozitat e këtij Kodi janë detyruese për të gjithë mësuesit dhe praktikantët që ushtrojnë praktikën profesionale në fushën e mësuesisë në institucionet arsimore në të gjithë sistemin parauniversitar.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij Kodi, çdo akt tjetër që lidhet me etikën e mësuesit, shfuqizohet.
4. Institucionet arsimore parauniversitare janë të detyruara të marrin masat për informimin, trajnimin dhe zbatimin e Kodit të Etikës së Mësuesit në nivel shkolle.